VENDIM
Nr. 137, datë 26.11.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PHOENIX PETROLEUM" SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa "c", të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe neneve 4, pika 1, germa "c"; 8; 9, pikat 1 dhe 2, germa "f" dhe nenin 10, pika 1, të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror", Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Phoenix Petroleum" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsu-matorit, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Phoenix Petro-leum" sh.a.,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Phoenix Petroleum" sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germa d/i, d/ii, d/v, d/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa e/i, e/ii, e/iii, e/v, e/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumente specifike për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa f/i) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa f/ii (mbi garancinë që cilësia e furnizimit të gaz të përmbushë kriteret minimale të operatorit të sistemit);
- nenin 9, pika 1, germa d/v (dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka);

- nenin 9, pika 2, germa f/iii (kapitalin financiar dhe mbështetja financiare e nevojshme për kryerjen e aktivitetit),

do të njoftohet subjekti, që në bazë të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Phoenix Petroleum" sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti